



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:157377

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647503

KPPP.nr. 1752/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “MALËSIA” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810196487 dhe me seli në Gjilan, rr. “Hamid Kokalari”, p.n., kundër debitorit “ANDI GROUP 2004” Sh.P.K., me numër të unik identifikues 811291046 dhe me seli në Gjilan, rr. “Abdullah Tahiri”, nr. 170, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 502/2022 i datës 13.07.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa nga Gjilani, jashtë seancës me datën 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “ANDI GROUP 2004” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 502/2022 i datës 13.07.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “MALËSIA” Sh.P.K., me datë 13.07.2022 ka lëshuar urdhrin P.nr. 502/2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 1649/22, e datës 11.04.2022; Faturës nr. 1648/22, e datës 11.04.2022; Faturës nr. 1647/22, e datës 11.04.2022; Faturës nr. 1588/22, e datës 07.04.2022; Faturës nr. 1558/22, e datës 05.04.2022; Faturës nr. 1524/22, e datës 02.04.2022; Faturës nr. 1487/22, e datës 31.03.2022; Faturës nr. 1486/22, e datës 31.03.2022; Faturës nr. 1485/22, e datës 31.03.2022; Faturës nr. 1326/22, e datës 25.03.2022; Faturës nr. 1191/22, e datës 17.03.2022; Faturës nr. 1143/22, e datës 14.03.2022; Faturës nr. 1074/22, e datës 10.03.2022; Faturës nr. 1073/22, e

datës 10.03.2022; Faturës nr.1072/22, e datës 10.03.2022; Faturës nr. 1030/22, e datës 07.02.2022; Faturës nr. 1029/22, e datës 07.03.2022; Faturës nr. 902/22, e datës 28.02.2022; Faturës nr. 811/22, e datës 24.02.2022; Faturës nr. 1191/22, e datës 17.03.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,852.65 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e lejimit, e deri në datën e pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, dhe atë në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në shumë prej 104.00 EUR.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrit Përmbartimor me arsyetim se propozimit për përmbartim nuk i janë bashkangjitur faturat si dokument i besueshëm por vetëm kartelën analitike e cila kartelë nuk konsiderohet si dokument i besueshëm. Ka shtuar se nga kartela analitike rezulton se debitori ka bërë pagesa të vazhdueshme ndaj kreditorit dhe se borxhi real nuk është si në propozimin për përmbartim. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe atë në vlerë prej 312.00 EUR, në emër të përpilimit të prapësimit.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se procedura përmbartimore është iniciuar në bazë të faturave të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas dispozitave të LPP-së, ku të njëjtat janë në origjinal dhe të nënshkruara, ashtu që janë pranuar nga debitori i cili nuk ka pasur vërejtje për të njëjtat. Ka shtuar se debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij, siç përcaktohet me nenin 69, par. 4 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkak që si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është

treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbaerim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 1649/22, e datës 11.04.2022; Fatura nr. 1648/22, e datës 11.04.2022; Fatura nr. 1647/22, e datës 11.04.2022; Fatura nr. 1588/22, e datës 07.04.2022; Fatura nr. 1558/22, e datës 05.04.2022; Fatura nr. 1524/22, e datës 02.04.2022; Fatura nr. 1487/22, e datës 31.03.2022; Fatura nr. 1486/22, e datës 31.03.2022; Fatura nr. 1485/22, e datës 31.03.2022; Fatura nr. 1326/22, e datës 25.03.2022; Fatura nr. 1191/22, e datës 17.03.2022; Fatura nr. 1143/22, e datës 14.03.2022; Fatura nr. 1074/22, e datës 10.03.2022; Fatura nr. 1073/22, e datës 10.03.2022; Fatura nr.1072/22, e datës 10.03.2022; Fatura nr. 1030/22, e datës 07.02.2022; Fatura nr. 1029/22, e datës 07.03.2022; Fatura nr. 902/22, e datës 28.02.2022; Fatura nr. 811/22, e datës 24.02.2022; Fatura nr. 1191/22, e datës 17.03.2022, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe të njëjtat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbaerim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbaerimit pasi që janë të përshtatshme për përmbaerim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbaerimor nuk janë të përshtatshme për përmbaerim, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se faturat janë pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori, ashtu që nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaerimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1752/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.